



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.1143/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët Afjete Sada-Glllogjani kryesuese, Kymete Kicaj dhe Ferki Xhaferi anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e paraqitur nga kandidati për kryetar të Komunës së Dragashit, Shaban Shabani, nga radhët e Subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Dragash, përfaqësuar sipas autorizimit nga Faton Fetahu, avokat nga Prishtina, kundër administrimit në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), të Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, të fletëvotimeve me postë, për Raundin e Dytë të Zgjedhjeve Lokale 2021, në seancën e panelit të mbajtur më datë 19.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

- I. PRANOHET** e bazuar ankesa e kandidatit për kryetar të Komunës së Dragashit, Shaban Shabani, nga radhët e Subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Dragash, e cila mban shenjën Anr.1143/2021 e datës 17.11.2021, **ANULOHEN** të gjitha fletëvotimet e dorëzuara përmes postës, për Raundin e Dytë të Zgjedhjeve Lokale 2021, të mbajtura më datë 14.11.2021, për kryetar të Komunës në Dragash.
- II. URDHËROHET** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, që fletëvotimet e anuluar si në pikën -I-, të dispozitivit të këtij vendimi, mos t'i përfshijë me rastin e shpalljes së rezultatit përfundimtar, për Raundin e Dytë të Zgjedhjeve Lokale 2021, të mbajtura më datë 14.11.2021, për kryetar të Komunës në Dragash.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë, më datën 17.11.2021, nga subjekti politik PDK, me të cilën ka pretenduar se gjatë procesit të Zgjedhjeve Lokale 2021 për Raundin e dytë, të mbajtura më datë 14.11.2021, për kryetar të Komunës në Dragash, ka pasur manipulime të zgjedhjeve të cilat kanë cenuar rëndë integritetin e procesit zgjedhor, duke devijuar vullnetin e shumicës

së zgjedhësve, e duke shkelur parimet kushtetuese e ligjore të fshehtësisë së votës, pacenueshmërisë së saj, dhe lirisë për të zgjedhur personalisht në mënyrë të barabartë të lirë dhe të fshehtë, ashtu si përcakton neni 45.2 Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Parashtruesi i ankesës më tej pretendon se pjesa më e madhe e zarfeve me fletëvotime të supozuara të dërguara me postë të ardhura nga Austria, Zvicra dhe Gjermania janë të organizuara nga më së shumti 3 persona, të cilët lehtësisht evidentohen me zarfet e mbishkruara me dorën e njëjtë nga i njëjti person për vend dërgesa të ndryshme si Linc-Donau, Haid bei Ansfelden, nga Viena dhe Cyrihu, të cilat në postë janë dërguar nga i njëjti person brenda disa minutave. Lidhur me këto pretendime parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur 5 deklarata, njëra e kryesuesit të vendvotimit 0501A/02D si dhe 4 deklarata të vëzhguesve të vendvotimeve si dhe kopje të pakove dhe zarfeve në të cilat kanë qenë fletëvotimet e supozuara. Kërkon nga PZAP-i, që të aprovohet në tërësi ankesa dhe të anulohen fletëvotimet të dorëzuara përmes postës në Raundin e Dytë të Zgjedhjeve Lokale 2021, për Kryetar të Komunës së Dragashit, dhe të urdhërohet KQZ-ja, që të shpallë Rezultatet Përfundimtare për Komunën e Dragashit duke i përjashtuar rezultatet e Votimit me postë.

Në përgjigjen në ankesën KQZ-ja, thekson se Lista e Votuesve jashtë Kosove për Komunën e Dragashit, përmban 1090 votues, të regjistruar suksesshëm gjatë periudhës së aplikimit për regjistrim për këtë Komunë. Lista përmban numrin e regjistrimit të votuesve jashtë Kosovës, mbiemrin, emrin, datën e lindjes, shtetin, numrin e telefonit dhe Komunën që i përkasin (Dragash). Më tej në përgjigje të KQZ-së, theksohet se lista me emrat e votuesve që u janë aprovuar pakot me fletëvotime, e që i përkasin Komunës së Dragashit përmban 308 votues, 284 votues të Komunës së Dragashit kanë dërguar pako me fletëvotim nga jashtë Kosovës, nga shteti i njëjtë ku dhe kanë deklaruar adresën në periudhën e aplikimit për regjistrim, dhe nga po të njëjtat shtete kanë dërguar pakot me fletëvotim. Ndërsa sa i përket votuesve të cilët kanë dërguar pako me fletëvotime nga jashtë Kosovës të cilët në periudhën e aplikimit për regjistrim si vendbanim në këta formular të regjistrimit kanë dhënë adresa shtete të ndryshme, në këtë rast nuk kanë dërguar pako me fletëvotime nga ato shtete që i kanë shkruar adresat në formular të aplikimit, që janë 24 gjithsej. Po ashtu për këtë komunë, sipas përgjigjes së KQZ së gjithsejtë janë pranuar **132 pako me fletëvotime**, ku në mesin e tyre 25 pako me fletëvotime nga shteti i Zvicrës, 2 pako me fletëvotime nga shteti i Sllovenisë, 11 pako me fletëvotime janë nga shteti i Gjermanisë, dhe 94 pako me fletëvotime nga shteti i Austrisë, dhe 1 pako me fletëvotim nga shteti i Francës.

Në fazën e procesit zgjedhor në të cilën është procesi i Zgjedhjeve Lokale 2021, paneli vlerësoi lejueshmërinë e paraqitjes së ankesës në këtë fazë të procesit dhe gjeti se ankesa është e lejuar në kuptim të nenit 105 par.1 të LZP, pasi që kemi të bëjmë me kërkesën e ankuesit sa i për ketë administrimit të fletëvotimeve me postë në QNR. Në nenin 105 par. 1 është përcaktuar se *“Ankesat lidhur me administrimin e numërimit në QNR dorëzohen me shkrim pranë PZAP-it brenda njëzet e katër (24) orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar”*, andaj paneli pasi që ka gjetur se ankesa është e lejuar, është lëshuar në meritat e vendosjes sipas kësaj ankese.

Paneli, pasi që vlerësoi secilën nga provat një nga një, dhe të gjitha së bashku, gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Paneli pas vlerësimit të pretendimeve ankimore, shkresave të lëndës, dhe hetimeve të bëra konstatoi se të dy pakot e fletëvotimeve të dorëzuara nga **shteti i Austrisë**, të familjes Sylejmani dhe familjes Aliu, e kanë dorëshkrimin e njëjtë me rastin e plotësimit të adresës së KQZ-së, në zarin mbështjellës të fletëvotimeve.

Pakot e fletëvotimeve të dorëzuara nga shteti i lartcekur, të familjeve Qollopek, Nafezi dhe Batjari, të tri këto familje e kanë dorëshkrimin e njëjtë me rastin e plotësimit të adresës së KQZ-së, në zarin mbështjellës të fletëvotimeve, madje te tri familjet e lartcekura ngjyra e lapsit e gjelbër ishte e njëjtë.

Pakot e fletëvotimeve të dorëzuara nga shteti i lartcekur, të familjeve Mahmuti, Shani, Kolloni, Isufi, të katër këto familje e kanë dorëshkrimin e njëjtë, me rastin e plotësimit të adresës së KQZ-së, në zarin mbështjellës të fletëvotimeve.

Paneli konstaton se nga pakot me fletëvotime të dorëzuara nga **shteti i Gjermanisë**, të familjeve Mustafa, Mehmeti, Abdurrahmani, Emini dhe Selimi, të pestat këto familjare rezultojnë se e kanë dorëshkrimin e njëjtë me rastin e plotësimit të adresës së KQZ-së, në zarin mbështjellës të fletëvotimeve.

Paneli konstaton se nga pakot me fletëvotime të dorëzuara nga votuesit prej **shtetit të Zvicrës**, të familjeve Jusufi dhe Avdiu, të dy këto familje e kanë dorëshkrimin e njëjtë, me rastin e plotësimit të adresës së KQZ-së, në zarin mbështjellës të fletëvotimeve.

Pakot e fletëvotimeve të dorëzuara nga shteti i lartcekur, të familjeve Nafezi, Halimi, Rasimi, Hajredini, Jonuzi, Rexhepi, Ajeti, Mustafa, dhe Jusuf, të gjitha këto familje e kanë

dorëshkrimin e njëjtë me rastin e plotësimit të adresës së KQZ-së, në zarfin mbështjellës të fletëvotimeve.

Pakot e fletëvotimeve të dorëzuara nga votuesit prej shtetit të lartcekur, të familjeve Skenderi, Jashari, Maliqi, Hajredini, Qafleshi dhe Selaj, të gjitha këto familje e kanë dorëshkrimin e njëjtë me rastin e plotësimit të adresës së KQZ-së, në zarfin mbështjellës të fletëvotimeve.

Pakot e fletëvotimeve të dorëzuara nga votuesit prej shtetit të lartcekur, të familjeve Sallahu, Reshiti, të gjitha këto familje e kanë dorëshkrimin e njëjtë me rastin e plotësimit të adresës së KQZ-së, në zarfin mbështjellës të fletëvotimeve.

Paneli konstaton nga vulat që janë vendosur në zarf nga postat pranuese, me rastin e pranimit të pakove të fletëvotimeve të lart cekura, se mënyra e dorëzimit në postë të këtyre pakove është pa dyshim e organizuar sepse siç u vlerësua më lart kemi të bëjmë me disa familje, me adresa të ndryshme brenda shtetit ku jetojnë dhe nuk është e mundur që të gjitha familjet së bashku ti dorëzojnë pakot e tyre në postë me fletëvotime në orët përfaqësues të njëjta (çështje minutash), dhe me data të njëjta, kur dihet që votimi për votuesit e diasporës zgjatë disa ditë, kjo mënyrë e organizimit të dorëzimit të pakove të fletëvotimeve nëpër posta është njëra ndër elementet që ndikon në minimin e integritetit të zgjedhjeve.

Nga raporti i statistikave të KQZ-së, për Zgjedhjet Lokale 2021, të raundit të dytë në Komunën e Dragashit, paneli konstaton se: 24 votues të Komunës së Dragashit, që kanë dërguar pako me fletëvotime nga jashtë Kosovës, të cilët në periudhën e aplikimit për regjistrim, si vendbanim në formularët e regjistrimit kanë dhënë shtete të ndryshme, pra nuk i kanë dërguar pakot me fletëvotime nga ato shtete që i kanë shkruar në formularë me rastin e aplikimit dhe që ishin regjistruar me adresën si votues jashtë Kosove. Prej votuesve të lartcekur, 10 prej këtyre votuesve kanë dërguar pako me fletëvotime nga Austria, ndërsa në formularët e aplikimit për regjistrim e kanë deklaruar se e kanë vendbanim në shtetin e Italisë, 6 votues, i kanë dërguar pako me fletëvotime nga shteti Austria, ndërsa në formularët e aplikimit për regjistrim e kanë deklaruar si vendbanim, shtetin e Gjermanisë, 1 votues ka dërguar pako me fletëvotime nga Gjermania, ndërsa në formularin e aplikimit për regjistrim e ka deklaruar si vendbanim, shtetin e Zvicrës, 2 votues kanë dërguar pako me fletëvotime nga Austria, ndërsa në formularët e aplikimit për regjistrim e kanë deklaruar si vendbanim, shtetin e Republikës së Çekisë, 4 votues kanë dërguar pako me fletëvotime nga Franca, ndërsa në formularët e aplikimit për regjistrim e kanë deklaruar si vendbanim, shtetin e Maqedonisë së Veriut dhe 1 votues ka dërguar pako me fletëvotime nga Austria, ndërsa në formularin e aplikimit për regjistrim e ka deklaruar si vendbanim, shtetin e Zvicrës. Nga kjo paneli

vlerëson se mënyra e pranimit për administrim në QNR, të këtyre pakove të fletëvotimeve të dorëzuara nga 24 votuesit e sipër cekur, duke mos e dhënë asnjë sqarim KQZ-ja, pse janë pranuar si të rregullta këto pako me fletëvotime që votuesi kur kishte aplikuar që të regjistrohet si votues jashtë Kosove, ishte regjistruar dhe certifikuar me një adresë në një shtet tjetër prej atij shteti që i kanë bërë dërgesat e pakove të fletëvotimeve, kjo nuk do të thotë që votuesit nuk kanë të drejtë ti ndërrojnë adresat e tyre sepse mund të jetojnë ku ata të dëshirojnë, por KQZ-ja, para administrimit në QNR, për raste të tilla duhet të bëjë verifikim më të thellë pse ka ardhur deri të ky ndryshim i vendbanimeve madje i shteteve të votuesve, e jo vetëm të merret me statistika se si janë regjistruar dhe nga cili shtet janë bërë dërgesat, ngase është përgjegjësi e plotë e KQZ-së, administrimi i saktë dhe pa asnjë dyshim i çdo mënyre të procesit të votimit, ngase edhe kjo e mënyrë e pranimit të këtyre pakove për administrim nga KQZ, pa asnjë sqarim shtesë e minon integritetin e procesit të votimit me poste.

Paneli vlerëson përfundimisht se procesi i votimit me postë nga votuesit jashtë Kosovës, për raundin e dytë të zgjedhjeve në Komunën e Dragashit është dëmtuar në atë masë sa që paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, ngase një pako me fletëvotime nënkupton një ekonomi familjare, ku brenda pakos me fletëvotime mund të jenë një apo shumë fletëvotime të votuesve të regjistruar paraprakisht në KQZ, si votues jashtë Kosove. Siç u konstatua më lart secila pako i përket një familjeje në vete, prandaj nuk është e mundur që familjet e lartcekura me rastin e plotësimit të adresës së KQZ-së, të kenë dorëshkrimin e njëjtë të plotësimit, të dorëzohen në dy, tri data të njëjtat të gjitha pakot e fletëvotimeve nëpër posta pranuese dhe në intervale kohore shumë të përfaqëta njëra nga tjetra, prandaj paneli këtë mënyrë të votimit nuk ka mundur ta pranoi si të rregullt. Andaj, mënyra e tillë e organizimit të votimit, vlerësohet nga paneli, si jo i ligjshëm dhe si i tillë e dëmton seriozisht procesin zgjedhor të raundit e dytë për Kryetar në Komunën e Dragashit. Për hetime të mëtejshme lidhur me elementet e veprës penale në këtë rast konkret, paneli duke u bazuar nënin 3 par.11 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, me Nr.02/2015, lëndën do ta dërgon në Prokurorinë e Shtetit, duke mos e paragjykuar ndonjë procedurë tjetër pasi që vendimet e PZAP-së, janë të karakterit administrativ.

Paneli duke u bazuar në të gjitha shkeljet e theksuar me larte dhe arsytet e dhëna, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi, duke u bazuar nënin 120 par.1 pika b) të LZP-së, ku përcaktohet se para certifikimit të rezultateve zgjedhore, është në kompetencë të PZAP-it, në raste të jashtëzakonshme të anuloi rezultatet në një vendvotim apo qendër votimi, nëse

konsideron se ka ndikim në rezultatin final, dhe në rrethana të jashtëzakonshme është në fushe veprimin e PZAP-së, për të evituar shkeljet dhe parregullsitë që janë evidentuara gjate procesit të votimit, në këtë rast me poste, duke mos përfshirë ato fletëvotime me rastin e shpalljes së rezultatit përfundimtar.

Andaj, paneli në kuptim të nenit 117, 118 dhe nenit 120.1 pika b) të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashresa

Anr.1143/2021 me datën 19.11.2021

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi, në Gjykatën Supreme të Kosovës.

Kryesuese e Panelit
Afijete Sadri Gillogjani

